

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tre shqiptarë mes 6 viktimave në tragjedinë e Athinës, ende mister shkaku i shpërthimit! Zbardhen pistat që po hetojnë autoritetet
ADRESA	https://tpz.al/tre-shqiptare-mes-6-viktimave-ne-tragjedine-e-athines-ende-mister-shkaku-i-shperthimit-zbardhen-pistat-qe-po-hetojne-autoritetet-i333961
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 18:48:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 18:45:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	456f5bc705d222261d1dcf5ef4b5595488dd8d56504806c06b66daf3e3464bc0
TEKSTI	0594c6904b6f9dc318e951bb92e7b545c4d9fcf031f8edb34964706747dc4087
PAMJA	1faf3f851494c0e720b5b901d39d30bd25b4ffb7e642fd063d80af49ed738706

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c3b92df1561ac6db5929c460a767e3d49b3a709821dedc0323bb8441b8cb3fff
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	bdb0f4977024bde548b4e3b2f30b00cf48adba46ab69ac7a79901c9e1751e8c0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c3b92df1561ac6db5929c460a767e3d49b3a709821dedc0323bb8441b8cb3fff>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

19:43 "Na ndërpreu takimin, shau dhe mallkoi", Braçe reagon pas përplasjes me aktivisten

19:26 Ndeshja Shqipëri-Bjellorusi, zbulohet sa bileta janë shitur

18:51 "Duh

AKTUALITET, 26 SEPTEMBER 2026, 20:45

Tre shqiptarë mes 6 viktimave në tragjedinë e Athinës, ende mister shkaku i shpërthimit! Zbardhen pistat që po hetojnë autoritetet

tpz.al TPZ



Çfarë e shkaktoi shpërthimin vdekjeprurës në Athinë të Greqisë? Kjo është pyetja që mbetet ende e hapur, pasi ka përfunduar operacioni për nxjerrjen e gjashtë trupave të pjetë nga rrënojat e ndërtesës në zonën e Plakës, pranë Akropolit.

Nga tragjedia humbën jetën gjashtë persona. Mes viktimave janë shtetas shqiptarë me origjinë shqiptare dhe shtetësi amerikane, ndër ta Florida Hoxha dhe bashkëshorti i saj Ian Alexander Kirkpatrick, i cili ishte martuar së fundmi, si dhe Eris Cani dhe bashkëshorti i saj, Florin Hoxha.

Sipas informacioneve të bëra publike, dy çiftet shqiptaro-amerikane kishin udhëtuar së bashku në Athinë. Florida Hoxha dhe Ian Alexander Kirkpatrick ishin martuar së fundmi dhe ndodheshin në Greqi për muajin e mjaltit, ndërsa Eris Cani dhe Florin Hoxha raportohet se ishin në pritje të një fëmije.

Dy viktimat e tjera ishin një çift i moshuar që banonte në katin e dytë të ndërtesës.

Dyshimet për rrjedhje gazi

Që në orët e para pas shpërthimit, skenari kryesor që po shqyrtohet nga autoritetet është ai i një rrjedhjeje gazi natyror. Dysohet se gazi mund të jetë grumbulluar në një hapësirë të mbyllur dhe më pas të jetë ndezur, duke shkaktuar shpërthimin e fuqishëm.

Vëmendja e autoriteteve është përqendruar veçanërisht te kati i dytë i ndërtesës, ku raportohet se kishte një lidhje me rrjetin e gazit natyror, që përdorej për kuzhinën dhe oxhakun.

Megjithatë, deri më tani nuk ka një konfirmim zyrtar se instalimi i gazit ka qenë shkaku i shpërthimit.

ide!

Ish-shefja e SHISH, nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiq të saj

Nga Lorenc Vangjeli

Rikthimi i SHISH-it në politikë si banalit


Nga Mero Baze

Teje e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super

Një element tjetër që po shqyrtohet është fakti se apartamenti në katin e parë, ku qëndronin katër shtetasit amerikanë, nuk kishte lidhje me gaz natyror dhe nuk përdorte bombola propani apo burime të tjera gazi.

imuniteti Gent Sejkos

[Shiko të tjera video](#)

Ekspertët po analizojnë rrënojat për të përcaktuar se nga cili ambient mund të ketë nisur shpërthimi dhe nëse ka pasur një problem në instalimet e gazit apo në ndonjë pajisje tjetër.

Shërbimi i Zjarrfikësve: "Nuk pati asnjë ankesë për erë gazi"

Një tjetër pikë që po hetohet është nëse ka pasur shenja paralajmëruese përpara shpërthimit.

Departamenti i Zjarrfikësve ka deklaruar se, para ngjarjes, nuk ishte bërë asnjë ankesë për erë gazi.

Ndërkohë, dëshmi të tjera të raportuara nga mediat greke kanë ngritur pretendimin se disa persona mund të kenë ndier erë të fortë gazi përpara shpërthimit.

Nëse konfirmohet se ka pasur rrjedhje gazi, ekspertët do të duhet të përcaktojnë se nga cili instalim ka ardhur ajo dhe përse nuk është konstatuar më herët.

Shpërthimi pranë Akropolit

Shpërthimi ndodhi mëngjesin e 25 shtatorit, rreth orës 07:35, në rrugën Lysikratous, në zonën historike të Plakës, pranë Akropolit.

Forca e shpërthimit shkaktoi shembjen e ndërtesës dykatëshe dhe dëmtime edhe në objektet përreth.

Në vendngjarje u angazhuan dhjetëra zjarrfikës, ekipe të specializuara të kërkim-shpëtimit dhe qen të trajnuar për kërkimin e personave nën rrënoja.

Ekipet përdorën kamera termike dhe pajisje të posaçme për të identifikuar shenja jete nën rrënoja. Operacioni i kërkim-shpëtimit vijoi për më shumë se 24 orë, deri në nxjerrjen e trupave të të gjashtë viktimave.

Fillimisht, autoritetet kishin raportuar gjashtë persona të zhdukur. Gjatë kërkimeve u gjetën edhe sende personale dhe dokumente që ndihmuan në identifikimin e personave që ndodheshin në ndërtesë.

Hetimet vijnë

Megjithëse rrjedhja e gazit natyror mbetet një nga skenarët kryesorë që po hetohet, shkaku përfundimtar i shpërthimit nuk është konfirmuar ende zyrtarisht.

Autoritetet po shqyrtojnë gjendjen e instalimeve të ndërtesës, mundësinë e një rrjedhjeje nga rrjeti i gazit, pajisjet që ndodheshin në ambientet e objektit, si dhe çdo provë tjetër që mund të ndihmojë në zbardhjen e ngjarjes.

Deri në përfundimin e ekspertizës teknike, mbetet e hapur pyetja se çfarë e shkaktoi shpërthimin që solli shembjen e ndërtesës dhe humbjen e gjashtë jetëve në zemër të Athinës.

Shqipëria e sotme nuk është
më vendi që ka nevojë për
ndihma! Kemi nisur krijimin e
regjistrit Kombëtar të
Diasporës

AKTUALITET / 26 September 2026, 19:55

Ndryshimet e Maran,
zbulohet formacioni i
Shqipërisë ndaj Bjellorusisë

AKTUALITET / 26 September 2026, 19:26

Ndeshja Shqipëri-Bjellorusi,
zbulohet sa bileta janë shitur

AKTUALITET / 26 September 2026, 18:26

Ambasadori Nesho komenton
ambasadorin Wendt: Yuri Kim
na prodhoi konflikt, por
Wendt ka integritet dhe nuk
përulet!

AKTUALITET / 26 September 2026, 18:05

Prokuroria i komunikon
akuzën Elvis Shkambit

AKTUALITET / 26 September 2026, 19:43

"Na ndërpreu takimin, shau
dhe mallkoi", Braçe reagon
pas përplasjes me aktivisten

AKTUALITET / 26 September 2026, 18:51

"Duhet respektuar
soveraniteti" / Kina
kundërshton SHBA-në për
Iranin dhe Kubën në OKB

AKTUALITET / 26 September 2026, 18:12

Ishte dënuar për vrasjen e
gruas, 49-vjeçari dyshohet se
është vetëvrarë në burgun e
Reçit

AKTUALITET / 26 September 2026, 17:43

["Po i çmontojnë një nga një",
Artan Hoxha ngre alarmin për
kriminalitetin në Sarandë](#)

[Senatorët republikanë dhe
demokratë thirrje Trump: Mos
e fto Putinin në samitin e G20](#)

AKTUALITET / 26 September 2026, 17:12

["As Netflix nuk do ta
imagjinonte. Skenar
apokaliptik"/ Artan Hoxha për
skandalin e Vlora Hysenit:
Këtë që ndodhi me SHISH-in
nuk do ta arrinte as një
shërbim armik](#)

AKTUALITET / 26 September 2026, 16:53

[Po transportonin emigrantë të
paligjshëm, dy "Audi" tentojnë
të ikin por përplasen me
patrullën e Policisë! Shpallen
në kërkim dy drejtuesit](#)

AKTUALITET / 26 September 2026, 16:38

[Edhe pulat nga Tajlanda/ 197
tonë mish përmes Kosovës,
raporti i KE ngre pikëpyetje
për kontrollet](#)

AKTUALITET / 26 September 2026, 16:32

[Pushimet që u kthyen në
tragjedi! Humbën jetën nga
shembja e ndërtesës në
Athinë, publikohen foton e
shqiptarëve](#)

AKTUALITET / 26 September 2026, 16:22

["Disa histori i kam jetuar, të
tjera...", çfarë po paralajmëron
ish-ministri Tahiri, publikon
videon 'enigmatike': Kam
shumë për të thënë](#)

AKTUALITET / 26 September 2026, 16:09

[Nga mbrojtja e rritja
ekonomike te lufta kundër
grupeve kriminale
transnacionale, Ambasada
Amerikane tregon prioritetet e
ambasadorit të ri të Trump në
Tiranë](#)

AKTUALITET / 26 September 2026, 15:21

Sa janë rritur kontributet? 8-mujori, mbi 1.4 miliardë euro derdhen në buxhet nga të punësuarit

AKTUALITET / 26 September 2026, 15:05

Ish-agjenti i CIA u sugjeron amerikanëve të jetojnë në Shqipëri, Bustamante: Nëse do të doja të zhvendosesha në Evropë, Shqipëria do të ishte në radarët e mi

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.